



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria – Vlada - Government*

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë - Ministarstvo Obrazovanja Nauke i Tehnologije  
- Ministry of Education, Science and Technology

Kabineti I Ministrit/ Kabinet Ministra/ Cabinet of the Minister

**UDHËZIM ADMINISTRATIV**

**Kriteret, procedurat dhe kategorite e studentëve përfitues të bursave nga MASHT-i për studime jashtë vendit**

**NUMËR: 32/2009**

**DATË: 15.09.2009**

Në mbështetje të neneve 93 (4) dhe 97 (2) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenit 25 paragrafit 7 të Rregullores së Punës të Qeverisë së Kosovës nr. 1/2007, nenit 30 të Ligjit të Arsimit të Lartë në Kosovë dhe nga nevojat e Kosovës për kuadro të reja dhe të profileve deficitare, nga mundësite e kufizuara ekonomike të tyre për të bartur të gjitha shpenzimet e këtij shkollimi jashtë vendit dhe nga nevojat që studentët tanë kanë për studime jashtë vendit, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe e Teknologjisë (në tekstin e mëtejshëm MASHT) nxjerr këtë udhëzim administrativ.

**Neni 1**

1. Ky Udhëzim administrativ për bursa (në tekstin e mëtejshëm UA për bursa) rregullon obligimet e MASHT-it ndaj studentëve që studiojnë jashtë vendit.
2. MASHT-I krijon skemë të bursave me qëllim të krijimit të kushteve për konkurrim dhe ndarje të drejtë efikase të fondeve për të ndihmuar studimet e kategorive të ndryshme të studimeve.

## **Neni 2**

1. Varësisht nga shuma e mjeteve në dispozicion dhe në bazë të prioriteteve strategjike të MASHT-it dhe nevojave arsimore të Kosovës, MASHT do të vendosë për dhënie të bursave për studentët kosovar që studiojnë në IAL në Evropë, dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës.
2. MASHT-i për studentët minoritarë do të ndajë 10%, nga shuma e përgjithshme e mjeteve të destinuar për bursa.

## **Neni 3**

1. Për ndarjen e bursave për studentë që studiojnë jashtë vendit, MASHT shpallë konkurs publik.

## **Neni 4**

1. Bursat do të jipen për tri nivelet e arsimit superior:
  - 1.1. Për nivelin Bachelor (30%)
  - 1.2. Për nivelin Master (40%)
  - 1.3. Për nivelin e Doktoraturës (30%)

## **Neni 5**

1. Kërkesës për burse kandidati duhet që t'i bashkëngjës:
  - 1.1. Vërtetimin për regjistrim në IAL,
  - 1.2. Vërtetimin për vitin e studimeve,
  - 1.3. Çertifikatën e notave,
  - 1.4. Kopje të indeksit/document identifikimi,
  - 1.5. Vërtetimin për statusin e studentit në vendin mikpritës.
  - 1.6. Letër reference nga profesorët
  - 1.7. Formularin e aplikimit

## **Neni 6**

1. Shuma e burses për një vit akademik do të jetë:
  - 1.1. Për nivelin Bachelor - 1.000 euro
  - 1.2. Për nivelin Master - 1.500 euro
  - 1.3. Për nivelin e Doktoraturës - 2.000 euro

## **Neni 7**

1. Për shqyrtimin e kërkesave për fitimin e bursave, MASHT-i do të formojë Komision të veçantë.

### **Neni 8**

1. Vendimin për ndarjen e bursës e merr MASHT-i, mbi bazën e propozimit të Komisionit.

### **Neni 9**

1. Në bazë të konkurrimit për vitin vijues, MASHT-i mund të vendosë vazhdimin e bursës edhe për një vit.

### **Neni 10**

1. Përparësi me rastin e fitimit të bursave do të kenë:
  - 1.1. Studentët që studiojnë drejtime deficitare (shkenca teknike, shkenca matematike-natyrore, shkenca bujqësore, psikologji, shkenca politike, arkitekturë, komunikacion, elektronikë, studime evropiane, artet).
  - 1.2. Studentët që kanë sukses të shkëlqyeshëm.
  - 1.3. Studentët që janë më afër përfundimit të studimeve.
  - 1.4. Studentët që studiojnë në vendet përendimore.
  - 1.5. Studentët që njohin gjuhën angleze.
  - 1.6. Studentët që njohin gjuhën e studimeve në vendin përkatës.

### **Neni 11**

1. Pas marrjes së vendimit për ndarjen e bursës, MASHT njofton kandidatin që e ka fituar atë.

### **Neni 12**

1. Me studentin i cili fiton bursën, MASHT-i do të nëshkruajë kontratën përkatëse e cila përcakton obligimet e të dy palëve kontraktuse.

### **Neni 13**

1. Palët kontraktuse obligohen të përmbushin obligimet e veta, të përcaktuara në Kontratë.
2. Pala e pakënaqur me vendimin e MASHT-it për ndarjen/mosndarjen e bursës ka të drejtën e ankesës.
3. Ankesat e kandidatëve i shqyrton Komisioni i vaçantë i MASHT-it.

### **Neni 14**


1. Kandidati, sipas Kontrates së nëshkruar, merr obligimin për të punuar 6 muaj pune në Institucionet publike të Kosovës për çdo vit akademik që ka shfrytëzuar bursën e MASHT-it.

### Neni 15

1. MASHT-i gëzon të drejtën të kërkojë informata për përparimin e studentëve të cilët shfrytëzojnë bursaj e saj.

### Neni 16

1. Ky UA hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të tij nga Ministri. Me hyrjen në fuqi të këtij udhëzimi shfuqizohet U.A nr. 41/2008 dt. 18.11.2008 I cili e ka rregulluar këtë çeshtje.

  
**Enver Hoxhaj, ministër**

